

BULETINI MUJOR **SHKURT 2026**

BANKA EUROPIANE E INVESTIMEVE MBËSHTET FAZËN E DYTË TË RESTAURIMIT TË MUZEUT HISTORIK KOMBËTAR



Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit nënshkroi me Bankën Europiane të Investimeve marrëveshjen për një grant asistence teknike prej 350,000 eurosh, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt restaurimit dhe rinovimit të plotë të Muzeu Historik Kombëtar.

Pas përmbylljes së fazës së parë, që përfshiu përforcimin strukturor dhe restaurimin e fasadave me financimin e programit EU4Culture, me mbështetjen e BEI Globale nis faza e dytë e projektit, e cila garanton

përgatitjen dhe projektimin teknik të rikonstruksionit të brendshëm, rishikimet e detajuara, zbatimin e konceptit të ri muzeal, si dhe mbikëqyrjen dhe menaxhimin profesional të çdo etape.

600 TË RINJ PËRMBYLLIN ME SUKSES PROGRAMIN KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS

600 të rinj zhvilluan praktikën pranë administratës publike, duke përfituar një mbështetje financiare prej 10,000 lekësh në muaj për tre muaj radhazi, në kuadër të thirrjes së 10 të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës. Ky program u konkretizua me 250 kontrata të para pune, si dëshmi e vlerësimit të meritës dhe angazhimit të tyre profesional. Në takim tradicional të organizuar në kuadër të mbylljes së kësaj thirrjeje, së bashku me Kryeministrin Edi Rama, Drejtoreshën e AKR-së, Sara Bodo, dhe përfaqësues të tjerë institucionalë, u theksua rëndësia e këtij programi si një urë konkrete drejt tregut të punës për të rinjtë.



PANAIRI “TOURISM FAIR ALBANIA”: SHQIPËRIA SI DESTINACION KONKURRUES DHE GJITHËVJETOR NË TREGUN NDËRKOMBËTAR

Në ceremoninë e hapjes së panairit “Tourism Fair Albania”, një platformë e rëndësishme bashkëpunimi e mbështetur nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, u theksua roli thelbësor i eventeve që bashkojnë institucionet publike, sektorin privat dhe partnerët ndërkombëtarë për të forcuar bashkëpunimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Në një moment kur Shqipëria po konsolidohet si një destinacion turistik gjithëvjetor, duke regjistruar mbi 12 milionë vizitorë të huaj gjatë vitit 2025, iniciativa të tilla shërbejnë si instrument strategjik për promovimin e ofertës turistike, forcimin e markës kombëtare dhe rritjen e konkurrueshmërisë së vendit në tregun ndërkombëtar.



BASHKËPUNIM STRATEGJIK ME GRUPIN E BANKËS BOTËRORE PËR TURIZËM ME VLERË TË SHTUAR



Në takimin me përfaqësuesit e World Bank Group, të kryesuar nga Ming Zhang, Drejtor Global për Zhvillimin Urban, Financat Nën-kombëtare, Turizmin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive, u diskutuan konkretisht hapat për orientimin e turizmit shqiptar drejt një modeli me më shumë cilësi dhe vlerë të shtuar për ekonominë lokale.

Fokusi i bisedës ishte zhvillimi i produkteve turistike përtej sezonit veror, veçanërisht në zonat malore, sitet e trashëgimisë kulturore dhe komunitetet lokale, si dhe rigjenerimi i destinacioneve përmes modeleve të suksesshme si PIUTD.

MOZAIKU I TIRANËS NOMINOHET PËR ÇMIMIN “NDËRTESA E VITIT 2026” NGA ARCHDAILY

Projekti “Mozaiku i Tiranës- Ndërhyrje Kulturore”, i realizuar nga SONarchitects, është nominuar për çmimin ndërkombëtar “Building of the Year 2026” nga ArchDaily, duke e vendosur Tiranën në hartën globale të arkitekturës bashkëkohore. Kjo ndërhyrje përfaqëson një model të suksesshëm të harmonizimit mes ruajtjes së trashëgimisë arkeologjike dhe qasjes moderne arkitekturore, duke krijuar një dialog të qëndrueshëm mes historisë dhe së tashmes. Nominimi konfirmon potencialin e kryeqytetit si një hapësirë ku identiteti kulturor dhe inovacioni ndërthuren në mënyrë dinjitoze, duke promovuar vlerat e trashëgimisë shqiptare në një platformë ndërkombëtare prestigjioze.



SHQIPËRIA NË LOJËRAT OLIMPIKE DIMËRORE MILANO-CORTINA 2026: NJË KAPITULL I RI PËR SPORTIN KOMBËTAR



Shqipëria shënon një moment historik me përfaqësimin për herë të parë në Lojërat Olimpike Dimërore Milano-Cortina 2026, duke konsoliduar një pikë kthese për zhvillimin e sporteve dimërore në vend. Ky sukses është rezultat i përkushtimit të sportistëve, trajnerëve dhe komunitetit sportiv, si dhe i mbështetjes së vazhdueshme të Qeverisë Shqiptare. Në Cortina 2026, Shqipëria u përfaqësua nga Laura Colturi, Denni Xhepa, Semire Dauti dhe Lisa Brunga, të cilët me arritjet e tyre kanë vendosur vendin tonë në hartën e skive elitare ndërkombëtare, duke hapur një kapitull të ri për sportin shqiptar dhe përfaqësimin dinjitoz të flamurit kuqezi në arenën olimpike.

KONSULTIM PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DONACIONET DHE SPONSORIZIMET”, DREJT NJË KUADRI MODERN DHE TRANSPARENT



Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit zhvilloi konsultimin publik për projektligjin “Për donacionet dhe sponsorizimet”, bashkë me Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të kuadrit ligjor dhe përafrimit me standardet europiane. Pas 32 vitesh, nisma synon të vendosë rregulla më të qarta, të forcojë transparencën dhe integritetin institucional, si dhe të krijojë Regjistrin Elektronik Kombëtar për donacionet dhe sponsorizimet, si një instrument i ri garantues për gjurmueshmërinë dhe llogaridhënien. Projektligji krijon një bazë më të fortë për mbështetjen e aktiviteteve me interes publik, veçanërisht në art, kulturë dhe sport, duke nxitur një klimë të re besimi dhe përgjegjshmërie.

MBI 20,000 VIZITORË NË SITET KULTURORE NË TË GJITHË VENDIN GJATË JANARIT 2026



Muaji janar 2026 konfirmoi interesin në rritje për trashëgiminë kulturore shqiptare, me mbi 20,000 vizitorë vendas dhe të huaj që vizituan muzetë, parqet arkeologjike dhe monumentet kulturore në mbarë vendin. Konkreisht, 11,315 vizitorë u regjistruan në Muzetë Kombëtarë, 6,012 në Parqet Arkeologjike dhe 2,693 në kala dhe monumente kulturore. Ndër sitet më të frekuentuara spikatën Muzeu Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu me 4,948 vizitorë, Parku Arkeologjik Shkodër me 3,475 vizitorë, Kalaja e Gjirokastrës me 2,167 vizitorë, Muzeu Ikonografik Onufri me 1,604 vizitorë dhe Parku Arkeologjik Butrint me 1,100 vizitorë. Këto shifra dëshmojnë jo vetëm interesin e qëndrueshëm për historinë dhe identitetin tonë kulturor, por edhe potencialin e turizmit kulturor si një shtyllë e rëndësishme e zhvillimit gjithëvjetor të vendit.

SEZONI VEROR 2026 – HAPEN APLIKIMET PËR STACIONET E PLAZHIT

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit njofton hapjen zyrtare të aplikimeve për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi për sezonin veror 2026.

Të gjitha bizneset që disponojnë strukturë akomoduese para ose pranë hapësirës së plazhit, mund të aplikojnë në këtë thirrje, ndërsa për herë të parë kjo mundësi ofrohet edhe për strukturat e shërbimit në plazhet përjashtimore.

Aplikimi kryhet online në portalin e-Albania, duke përzgjedhur shërbimin “Kërkesë për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi”, ku duhet të plotësohen kriteret përkatëse dhe të ngarkohet dokumentacioni i nevojshëm.

